

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Varrezat masive në Zubin Potok, Kurti: Konfirmohet identiteti i tri viktimave, i përkasin 'Grupit të Intelektu alëve' - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/varrezat-masive-ne-zubin-potok-kurti-konfirmohet-identiteti-i-tri-viktimave-i-perkasin-grupit-te-intelektualeve
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 13:05:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 13:04:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	da238d95d61b917de6fa35f5b8d24d92f6e05b2061be1d96782aad387564e02b
TEKSTI	2f7d806eff07cdb1072cc6dbe76223f3139115662e2bdb10a222c6b701d99257
PAMJA	8cc0e904f26424d93aea920256c8c804fac032a1ac348be985fa436e1096a7f7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	90f36d67de700c48d52bc20feecdfbc035cfc916639753bf2c1a520bbddf7d1e
E MËPARSHMJA	73d4b86794335153f827be81a58e07aa88b3c9cf4f76467ba0950ebf2d6898ba
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/90f36d67de700c48d52bc20feecdfbc035cfc916639753bf2c1a520bbddf7d1e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Derisa të jemi kaq të keqin dhe kunder njëri-tjetrit përballë të huajve...



Kosova & Rajoni

Varrezat masive në Zubin Potok, Kurti: Konfirmohet identiteti i tri viktimave, i përkasin 'Grupit të Intelktualëve'

Varrezat në Zbui Potok u zbuluan rreth dy muaj më parë pas një hetimi dyvjeçar lidhur me dyshimet për krime lufte, sipas autoriteteve kosovare.



Foto e një punonjësi policie në Kosovë



Redaksia

19 Shtator, 15:00 | Përditësimi: 19 Shtator, 15:04

Share Tweet

A A

Kryeministri i Kosovës, **Albin Kurti**, ka njoftuar të shtunën se është konfirmuar identiteti i tri viktimave pas zhvarrimit të mbetjeve mortore të zbuluara në **varreza** masive në lokacione të ndryshme në veri të Kosovës.

Kurti shkroi në Facebook se raportet e ADN-së kanë konfirmuar se tri viktimat i përkasin grupit të njohur si "Grupi i Intelktualëve", kryesisht qytetarë nga Skenderaj dhe Mitrovica, të rrëmbyer dhe të zhdukur me dhunë më 19 prill 1999 nga forcat serbe.

Kryeministri nuk tregoi me emër dhe mbiemër se kush ishin viktimat, por tha se familjet e tri viktimave të identifikuar janë njoftuar qysh sot.



LEXO EDHE:

Kosovë/ Varrezat masive në Zubin Patok, identifikohen 3 prej viktimave! Pjesë e 'Grupit të Intelktualëve' shqiptarë që u rrëmbyen nga forcat serbe

Njoftimi i tij vjen gati dy muaj pasi u zbuluan tri varre masive në këtë komunë në veri të vendit, ku u gjetën mbetje mortore të së paku 23 njerëzve.

Në fund të muajit të kaluar, autoritetet kosovare i dërguan në Hagë të Holandës mostrat e mbetjeve mortore të zhvarrosura në lokacionet e varreve masive në Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut.

Kurti tha se Kosova pret t'i pranojë edhe raportet e tjera për mostrat e dërguara për identifikim përmes analizës së ADN-së "në ditët dhe javët në vijim".





"Me shpresën që edhe familjet e tjera të marrin përgjigjet që presin prej 27 vitesh. Asnjë përgjigje nuk mund ta shuajë dhimbjen e humbjes, por njohja e së vërtetës i jep fund ankthit të pritjes për të mësuar fatin e më të dashurve", tha Kurti.

Varrezat në Zbun Potok u zbuluan rreth dy muaj më parë pas një hetimi dyvjeçar lidhur me dyshimet për krime lufte, sipas autoriteteve kosovare.

Prokuroria Speciale e Kosovës po i heton për këtë rast katër persona, J.R., M.J., R.K dhe M.B., të dyshuar për krime lufte kundër popullsisë civile. Që të katër ndodhen në paraburgim.

Njëri nga të arrestuarit, sipas autoriteteve, dyshohet se në kohën e luftës kishte qenë pjesë aktive e Armatës Jugosllave.

Sipas Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në **Kosovë**, 1.577 persona vazhdojnë të jenë të zhdukur nga lufta e viteve 1998-1999, ndërsa janë dokumentuar gjithsej 12.230 viktima të luftës.

Kosova ka kërkuar vazhdimisht nga Serbia bashkëpunim për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe qasje në arkivat ushtarake që sipas autoriteteve mund të ndihmojnë në identifikimin e lokacioneve të varreve të mundshme.

Kurti, i cili ndodhet në Shtetet e Bashkuara dhe për sesionin e 81-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, tha se do t'iu kërkojë Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Britanisë së Madhe, ta shtojnë trysinë ndaj Serbisë për t'i zbatuar zotimet për hapjen e arkivave, për të ndihmuar në gjetjen e vendndodhjes së njerëzve të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë. **REL**

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: [Albin Kurti](#) [kosove](#) [varreza](#) [zubin patok](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



5.0 / 5 (2 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet reptesisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, arrestohet në Morinë 34-vjeçari nga Kosova (EMRI)

20 Shtator, 11:31



Vendimi ndaj ish krerëve të UÇK-së, Kurti nga SHBA: Duhet strategji shtetërore dhe bashkëpunim me aleatët tanë ndërkombëtarë

19 Shtator, 22:52



Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

19 Shtator, 21:58



Dënimi i liderëve të UÇK, Prishtina sërish në protestë! Tubime në Gjermani e Austri

19 Shtator, 21:43



Adri Nurellari: Pas deklaratës së Kuvendit tek veprimi, çfarë duhet të bëjë Shqipëria për Kosovën



Adri Nurellari

19 Shtator, 18:58



Kosovë/ Hamza viziton familjet Thaçi, Veseli dhe Krasniqi: Do të vazhdojmë betejën për drejtësi deri në kthimin në atdhe të luftëtarit të fundit të lirisë

19 Shtator, 18:49



Dënimi i krerëve të UÇK-së, avokati i Thaçit 'zbërthen' pasojat e verdiktit: Specialja po njollos luftën e UÇK-së, e lidhi pavarësinë e Kosovës me krimet e luftës

19 Shtator, 10:16



'Jo në emrin tim'- Protestuesit mbushin sheshe e rrugë në Prishtinë, kundërshtojnë vendimin e Hagës për 4 ish-krerët e UÇK (FOTO)

18 Shtator, 21:54



Adrian Thano: Sa më shumë korrupsion, aq më pak sovranitet



Adrian Thano

18 Shtator, 21:14



Zgjedhjet në Serbi, OSBE e gatshme të mbledhë votat në Kosovë, por pret miratimin e institucioneve vendase

18 Shtator, 16:21



Dënimi i Thaçit, Ralf Gjoni rrëfen prapaskenat e krijimit të Speciales: Po ta dinte se do përfundonte në burg, nuk do ta votonte kurrë! Tirana dhe Prishtina u treguan naive

18 Shtator, 15:17



Gucati thirrje Kurtit: Përrjashtojë Gërvallën, njerëzit që bashkëpunojnë me armikun janë armiq të kombit

18 Shtator, 12:51

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.